



BASHKIA VLORE

RIKONSTRUKSION I BLLOKUT TE
BANIMIT QE KUFIZOHET NGA RRUGET
“BULEVARDI ISMAIL QEMALI –
SULEJMAN DELVINA – MUSTAFA
BELLO” – Vlorë

1. Vendodhja ne lidhje me Qytetin e Vlores

Zona e marre ne studim eshte nje zone kryesore e cila pozicionohet ne qender te qytetit te Vlores. Ne saj te pozicionit, kjo kufizohet nga rruge qe perbejne arterie kryesore me rendesi te larte ekonomike.

Ne qender te ketij blloku banimi ndodhet kampusi universitar, nje nder zonat me te frekuentuara nga studentet pasi aty ndodhen godinat e studimit si dhe konviktet.

Kjo zone kohet e fundit ka marre zhvillim si pasoje e nderhyrjeve te rikonstruksionit te Bulevardit Ismail Qemali dhe te Rruges Sulejman Delvina. Gjithashtu rol te rendesishem ne zhvillimin e ketij blloku do te luaje dhe sistemimi i ambjenteve perreth konviktit dhe shkolles mjekesore si dhe te shkolles 9 vjecare Muco Delo. Kjo hapesire karakterizohet nga nje relief pothuaj fushor me thyerje te vogla dhe jo te perfilleshme.

Zona fillon nga jugu i kinoteatrit dhe kufizohet ne perendim nga bulevardi Ismail Qemali, Ne lindje kufizohet nga rruga e unazes Sulejman Delvina dhe ne jug nga rruga Mustafa Bello



Siperfaqja e zones e marre ne studim eshte rreth 6.1 Ha. Ne brendesi te kesaj zone ndodhen objekte te ndertuara rreth viteve 1960-1970 me lartesi katesh 3-5 kate por gjejme gjithashtu dhe objekte te ndertuara gjate viteve te fundit me lartesi katesh 8-9 kate. Gjithashtu ne brendesi te kesaj zone gjejme dhe objekte te ndertuara pa leje ndertimi disa prej te cilave do ti nenshtrohen prishjeve me qellim krijimin e hapesirave publike.

2. Gjendja ekzistuese

Ne segmentin rrugor te propozuar mund te themi se infrastruktura KUB eshte ezistuese por ne disa vende duhet zevendesuar pasi ka dale jashte funksionit. Persa i perket KUZ ato jane ekzistuese dhe funksionale ne te gjithë zonen e marre ne studim. Kjo zone eshte furnizuar mjaftueshem me energji elektrike. Si perfundim mund te themi se infrastruktura ne zone eshte e plote me perjashtim te nderhyrjeve qe jane menduar te realizohen ne rrjetin KUB. Gjendja e asfaltit ne pjesen jugore te bllokut eshte jo e mire dhe per kete arsye do te zevendesohet. Trotuaret jane te demtuara dhe ne nje pjese te zones nuk ekzistojne. Ne pjeset e tjera do te kete rikonturim te bordurave te trotuareve ekzistuese. Persa i perket ndricimit ai eshte jo i mjaftueshem dhe shumica e ndricuesve jane jo funksionale.



Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese

Ne brendesi te bllokut te marre ne studim ndodhen godinat e konvikteve te studenteve, Shkolla e larte mjeksore, palestra e qytetit si dhe Shkolla 8 vjecare Muco Delo. Territoret rreth objekteve te mesiperme paraqiten te degraduar si pasoje e mos nderhyrjes ne vite. Gjithashtu dhe objekti i palestres se nuk eshte ne brendesi te saj ne kushtet e duhura.

3. Nderhyrjet e parashikuara ne Projekt

Nderhyrjet filllestare konsistojne ne shembjen dhe me pas pastrimin e objekteve 1 kat si dhe te mureve rrethues te cilat pengojne realizimin e projektit te zbatimit.


- ***Punime ne rrugen Mehmet Cico Petoshati***

Punimet ne kete rruge konsistojne kryesisht ne gerrmimin e kanalit per shtrimin KUB Ø 400 mm i cili do te shkarkoje ne dy pika lidhjeje me rrjetin ekzistues te Ujrave te Bardha te qytetit te Vlore. Ky tubacion ne veri te tij do te lidhet me tubacioni KUB Ø1200 mm dhe ne pjesen jugore me tubacion Ø400 mm. Pergjat tubacionit Ø 400 do te vendosen puseta qendrore cdo 25-30 ml te paracaktuara ne projekt sebashku me pusetat anesore te shiut. Mbas shtrimit te tubacionit do te mbushet kanali i gerrmuar me materiale te trupit te rruges dhe ne fund da te riasfaltohet e gjithë rruga. Pergjate rruges jane krijuar dy parkime. Eshte parashikuar nga projektuesi dhe ndertimi i trotuarev ne dy anet e rruges sebashku me shtresat perkatese. Ne piken ku kjo rruge kryqezohet me rrugicen dalese ne bulevard, pikerisht ne kete zone eshte menduar perdorimi i pllakave te gurit. Pergjate kesaj rruge do te vendosen ndricues te tipit AREO

- ***Rruge te reja qe hapen ne brendesi te bllokut***

Ne brendesi te bllokut te banimit eshte krijuar mundesia e krijimit te siperfaqeve rrugore te reja te cilat do te realizohen mbas lirimit te hapesirave te zena nga ndertimi kaotik dhe abuziv. Keto rruge do te kene shtresat e meposhtme te trupit te rruges dhe do te kene gjeresi qe varion 3.00m-4.00ml:

- Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri.
- Shtrese çakelli mbeturine kave t=2x15cm, perhapur e ngjeshur makineri
- Nen Shtrese stabilizant 10cm + cilindrim rul 8-12ton
- Shtrese binderi me granil gur kave, 4cm, me makineri
- Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri




Ne dy anet e rrugëve do të ndertohen trotualet anesor me gjerësi rreth 1.5 m. Në këto rrugë është parashikuar dhe ndërtimi i KUB së ri i cili do të lidhet me rrjetin ekzistues. Përgjatë kësaj rrugë do të vendosen ndricues të tipit si në projektin e ndricimit.


- ***Punime ndërtim trotuaresh***

Zonat e reja në të cilat është parashikuar ndërtimi i trotuaresh janë dy:


Zona e parë përfshin rrethinat e Kinoteatrit Petro Marko si dhe pjesën lindore të tij. Kjo zonë është menduar të shtrohet me pllakë guri gelqeror sipas modelit të bulevardit Ismail Qemali pikërisht për të evidentuar rëndësinë kësaj godine monumentale.




Zona e dyte perfshin dyshesht qe krijohen si pasoje e lirimit te hapesirave te cilat ndodhen ne afersi te rruges Sulejman Delvina me rrugen Mustafa Bello pra ne pjesen juglindore te bllokut te marre ne studim. Ne kete zone do te ndertohen trotuare prej betoni te derdhur dhe te ilustruar.



Ne te dy zonat e siperpermendur siperfaqet e lira do te jene te arrehuara me stola-bordure kufizues te gjelberimit te parafabrikuar me te njejten cilesi si ato te krijuar ne sheshin Avni Rustemi.



Detaji i stolit kufizues gjelberimi



- ***Punime riparimi ne rruget ekzistuese te bllokut te banimit***

Eshte parashikuar heqja e asfaltit te vjeter I cili eshte I demtuar dhe zevendesim I tij ma asfhalt te ri. Gjthashtu eshte parashikuar dhe nj konturim i ri i bordurave

kufizuese te rrugeve me qellim shfrytezimin sa me te mire te siperfaqeve. Ne preventivin e punimeve jane parashikuar dhe shtresat rrugore dhe te trotuareve te cilat shtohen si pasoje e rikonturimit te bordurave anesore te trupit rrugor. Pergjate kesaj rruge do te vendosen ndricues dhe do te hiqen shtyllat ekzistuese.

- ***Punime ne brendesi te territorit te Shkolles Mjeksores dhe te Qytetit Studenti Vlore***

Ne projekt propozimin eshte rikonceptuar nje “kampus” i ri universitar, ne te cilin propozihet krijimi i nje zonimi te ri funksional, duke perfshire:

- a) Propozimin e nje aksi te ri kalimi, me akses nga bulevardi “Ismail Qemali”, kalim permes kampusit universitar dhe dalje ne rrugen “Sulejman Delvina” (aktualisht hyrja kryesore).
- b) Rigrupimi i hapësirave sportive, prane godines se palestres se qytetit me mundesi aksesit nga brenda kampusit, duke krijuar nje kend te ri sportiv.
- c) Sistemimin e gjithe hapësirës brenda kampusit universitar (trotuare, gjelberim, ndricim, hapësirat rekreative, por jo dy godinat e propozuara).
- d) Rigrupim te konvikteve te studenteve (propozimin e nje ndertese te re me kushte optimale per konviktin e djemve).
- e) Rigrupim te dy godinave te studimit (Fakultetit te Shkencave Humane dhe Fakultetit te ri te Shendetit Publik).
- f) Riparime ne palestren e qytetit te cilat do te prekin kryesisht catine dhe fasadat e godines

Pergjate aksit te ri te kalimit do te perdoret shtrim me pllaka si ne boulevard ndersa ne pjesen tjeter te mbetur do perdret shtrimi me beton te ilustruar. Eshte parashikuar dhe kanalizimet e ujrave te bardha ne projekt. Ne dy parkimet e kijuara do te perdoren shtresat rrugeve te perdorura dhe ne brendesi te bllokut te banimit. Ne brendesi te kesaj hapësire do te vendosen ndricues te tipit 808x150x80 me dy hapje ne 4 dhe 8 m si ne figure.



- ***Punime per fushen e sportit te shkolles Muco Delo***

Punimet konsistojne ne zevendesimin e fushes ekzistuese me nje fushe te re nepermjet heqjes se shtresave te demtuara te saj si dhe ndertimin e shtresave te reja.

- ***Punime per riparimin e palestres se qytetit***

Punimet konsistojne ne riparimin e suvatimeve te brendeshme dhe te jashtme si dhe ne zevendesimin e nje pjese te catise ekzistuese.

- ***Punime ndricimi***

Ne te gjithë zonen e marre ne studim jane parashikuar te vendosen tre tipe ndricuesish. Ndricuesit jane perzgjedhur nga projektuesit ne saj te formes dhe te funksionit. Llojet e ndricuesve jane si ne figure:



Shtylla me dy hapje ne 4 dhe 8 m, 808x150x80 me dy hapje ne 4 dhe 8 m 4000K, 5940 lm H=8m.



Ndricules i llojit IP 66, IK 08 322x218x190 H=7m

Shtylla alumin i anodizuar, IP 66, Fuqia 30W-120W, 3000-6500K, 5100-20400 lm.

- ***Punime riparimi ne fasaden e Palestres se qytetit***

Eshte menduar gjithashtu te realizohet suvatimi dhe lyerja e fasades se palestres se qytetit si dhe nderrimi i ullukeve horizontal dhe vertikal te godines.

- ***Kanalizimet e Ujrave te Zeza***

Projekti i K.U.Z. eshte i plote dhe funksional ne zonen e marre ne studim dhe per kete arsye nuk eshte parashikuar te kryen punime per ujrat e zeza.

4.Plan Organizimi i punimeve, Plani kalendar

Punimet do te zbatohen nga firma kontraktore ne perputhje me plan-organizimin dhe planin kalendarik te hartuar dhe miratuar prej 12 muajsh

Ne planin kalendarik percaktohet fillimi dhe mbarimi i objektit, kohezgjatja e çdo lloj punimi qe do te kryhet, duke respektuar me rigorozet kushtet teknike te zbatimit dhe radhen teknologjike.

Ne plan organizimin e punimeve parashikohen te gjitha masat organizative per te realizuar punime me cilesi dhe ne perputhje me specifikimet teknike.

Ne plan organizim percaktohen:

1. Ngritja e kantjerit
2. Linjat provizore, sidomos ato te furnizimit me energji
3. Vend-depozitimet e materialeve
4. Skemat organizative
5. Levizja provizore e mjeteve te transportit, te makinerive dhe mekanizmave qe do te perdoren

Ne plan organizim parashikohen me pergjegjesi masat per sigurimin teknik dhe mbrojtjes ne pune te shoqeruara me pajisjet e domosdoshme dhe mjetet paralajmeruese.

Parashikohen burimet nga do te furnizohemi me baze materiale, menyren e shfrytezimit te kavos.

Per mbushjet e trupit te rruges jane te pershtatshme zhavorret ne shtratin e lumit Shushice dhe materialet shkembore ne karieren e Radhimes.

Karierat e Radhimes perbehen nga shkembinj te forte gelqerore qe plotesojne kushtet per te prodhuar materiale per betone dhe asfalte.

Zbatohet kjo rradhe pune:

- Piketimi i rrugeve azhornimi i projektit te hartuar me terrenin faktit, evidentimi i problemeve nese dalin,
- Germimi i dherave ne trup rruge gjer ne taban me mekanizma dhe transport me auto ne venddepozitimin e percaktuar nga Bashkia Vlore. Depozitimi ne vende te caktuara sipas plan organizimit te dherave me perzgjedhje nga germimi qe do perdoret ne zonat e gjelberuara.
- Mbushja e trupit te rruges sipas prerjes terthore me zhavorr, vendosje gjeotekstili, çakell me mina.
- Punimet e tjera qe lidhen me vendosjen e bordurave, tubacioneve te kanalizimit per ujrat siperfaqesore apo tubacionet per ndricimin, betonimi i kunetes, ndertimin e pusetave, te bazamenteve prej betoni apo shtrese betoni, shtresave asfaltike etj. Te gjitha punimet kryhen ne perputhje me specifikimet teknike te parashikuara shoqeruar me gjithë dokumentacionin e plote tekniko-ekonomik qe verteton sasine dhe cilesine e punes se kryer.

Para fillimit te punimeve hartohet plani kalendarik.

Ne planin kalendar pasqyrohet fillimi i objektit, afati i perfundimit, fillimi dhe mekanizimi i çdo lloj proçesi pune duke zbatuar me rigorozitet radhen teknologjike dhe kushtet teknike te zbatimit.

Plani kalendarik shoqerohet :

- grafikun e makinerive dhe pajisjeve;
- skemat e levizjes se makinerive, mekanizmave si dhe skemat e ngritjes per montimin e elementeve te parapergatitur;
- grafikun e fuqise punetore e specialiste
- planin material
- programin mbi organizimin e kontrollit per zbatimin e punimeve ne sasi e cilesi.

Nese gjate zbatimit te punimeve do te haset ne situata jo te parashikuara per te cilat kerkohet ndryshim, per keto ndryshime do te kerkohet dakordesia e projektuesve.

Si pika reference per piketimin e rrugeve te propozuara jane marre objektet ekzistuese te paraqitura dhe ne planin e piketimin. Subjekti ndertues perpara fillimit te punimeve te ndertimit per bllokun e banimit duhet te kryeje azhornimin topografi te terrenit.

Punoi.

Ark. Fatjon DEVOLLAJ

Ark. Klaudio Mehmetaj

Ark. Rubin Hekurani

Ing. Darjan HUDHRA